



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departament Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 25/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përfaqësuesit të Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, z. Petrit Recica, pala ankuese [REDACTED], dhe përmbaruesit privat, [REDACTED] dhe pas seancës këshillimore, me datën 18.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-25/2021, datë 26.08.2021, Raporti i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira, dt 24.08.2021, ankesa e palës ankuese [REDACTED] nga Prishtina, dt 13.07.2021, si të paafatshme.

A R S Y E T I M

Me datën 26.08.2021, Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, mbi bazën e ankesës së paraqitur nga pala ankuese ka ngritur në Komisionin Disiplinor propozimin për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat : [REDACTED] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat [REDACTED] ka zbatuar procedurën e përmbarimit mbi bazën e një dokumenti jo përmbarimor, në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Pas sigurimit të informacioneve dhe shkresave, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira (tash e tutje Divizioni) ka përpiluar Raport me të cilin konstaton që përmbaruesi privat [REDACTED] ka vepruar në kundërshtim me nenin 21, 22 dhe 29 të LPP-së. Sipas raportit, përmbaruesi privat z.

[REDACTED] me urdhrin P. nr 620/19 dt 28.03.2019 ka lejuar përbarimin sipas propozimit për përbarim të kreditorit [REDACTED] Sh.P.K, mbi bazën e Vendimit nr. 12689 dt 28.12.2015, i cili vendim përcakton tarifën për një vit të studimeve e cila për vitin 2015/2016 ishte përcaktuar 800 Euro duke përfshirë shpenzimet procedurale ndërsa pagesa nga pala debitore është bërë me dt 12.04.2019 në vlerën totale prej 502.02 euro. Sipas parashtruesit, Vendimi i këtij lloji nuk përfshihet në dokumentet e renditura nga neni 21, 22 dhe 29 të LPP-së dhe nuk gëzon besueshmërinë e përbarimit apo nuk ka titull ekzekutiv. Vendimi i [REDACTED], Sh.P.K, nr. 12689 dt 28.12.2015 nuk është lëshuar në procedurë administrative nga organet administrative apo nga personat juridik që janë të ngarkuar apo bartin autorizime publike sepse universitetet private, në këtë rast, [REDACTED] nuk përbën organ administrativ që ofron shërbime publike dhe si të tilla këto lloje të vendimeve nuk mund të konsiderohen kategori e vendimeve sipas nenit 22 par 2 të LPP-së. Përveç kësaj, parashtruesi thekson që shumën për pagesë prej 800 euro për një vit (viti 2015/2016) e paraqitur në dokumentin përbarues bazë të cilësuar si të besueshëm nga ana e përbaruesit privat, Vendimit nr 12689 [REDACTED], është në shpërputhje të plotë me shumën e paraqitur në propozimin për përbarim dhe urdhrin P. nr 620/19 që pagesa është në vlerë prej 397 Euro për dy vite. Po ashtu, sipas parashtruesit, pala debitore ka bërë pagesën me dt 12.04.2019 në vlerën totale prej 502.02 Euro që përfshinë edhe shumën për tarifën e efikasitetit përkundër që pala debitore ka përmbushur detyrimin e tij brenda afatit për përmbushje vullnetare, që do të thotë që në rastin konkret përbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr 04/2014 për tarifatat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përbaruesit privat lidhur me nenin 27 par 2 të LPP-së.

Përbaruesi privat [REDACTED] në përgjigjen e tij me shkrim deklaroi se lënda përbarimore në fjalë është administruar me dt 27.03.2019 dhe e njëjta është përfunduar me dt 12.04.2019 dhe rrjedhimisht bazuar në nenin 375 të LPP edhe po të ekzistonte ndonjë shkelje eventuale në këtë lëndë, ka kaluar afati brenda të cilit mund të iniciohet procedurë disiplinore. Përbaruesi privat thekson se Divizioni ka tejkalluar kompetencat e tij të përcaktuara me nenin 359 të LPP-së dhe Udhëzuesin e MD-së për mbikëqyrjen e punës së përbaruesve privat duke trajtuar *ligjshmërinë* e vendimit meritor përkatësisht urdhrin për përbarim. Ligjshmëria e vendimit përkatësisht urdhrin për përbarim bie në kompetencë të Gjykatave të rregullta në procedurë gjyqësore sipas nenit 5 par 5 të LPP-së. Sa i përket pretendimit se procedura përbarimore është zbatuar në bazë të një dokumenti jo përbarimor, përbaruesi privat thekson se në rastin konkret ishin plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lejimin e përbarimit sipas nenit 22 par 1.2 lidhur me nenin 23 par 2 dhe nenin 24 par 3 të LPP-së sepse bartësit privat të arsimit të lartë me vet faktin e licencimit nga Ministria e Arsimit dhe akreditimit nga Agjensioni i Akreditimit fitojnë statusin e barabartë me bartësit tjerë të arsimit të lartë sipas Ligjit për Arsim të Lartë. Rrjedhimisht, vendimet e nxjerra nga këto institucione konsiderohen vendime të nxjerra në procedurë administrative dhe nga organi administrative sipas nenit 23 të LPP-së. Përbaruesi privat thekson se para se të nxirret vendimi për regjistrimin e studentit (i cili ka shërbyer si dokument përbarimor) kreditori ka zhvilluar procedurë administrative sipas kërkesës së vet aplikuesit/studentit duke i bashkangjitur dokumentet tjera relevante të kërkuara nga institucioni dhe pas shqyrtimit të kërkesës së palës dhe dokumenteve përkatëse është nxjerr vendimi për regjistrim të studentit. Meqenëse vendimi është nxjerrë sipas kërkesës së palës, atëherë konform nenit 49.2 të Ligjit për Procedurën Administrative nr 05/L-031, akti mund të përbëhet vetëm nga dispozitivi në formë të shkruar pa pasur nevojë për arsyetim dhe këshillë juridike. Gjithashtu, përbaruesi privat thekson se janë shqyrtuar edhe kërkesat që dalin nga nenin 36 të LPP që lidhen me përbarueshmërinë e dokumenteve

përmbartimore dhe ka gjetur se së bashku me vendimin, shkresave të lëndës i është bashkangjitur edhe një vërtetim ku tregohet vijueshmëria e studentit në studime dhe në paragrafin e fundit është klauzola që dëshmon se vendimi për regjistrim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Sipas përmbartuesit privat gjykatat e rregullta në një numër rastesh kanë konstatuar se vendimet e tilla janë tituj ekzekutiv përkatësisht vendime të nxjerra në procedurë administrative apo dokumente të besueshme sipas nenit 29 par 1.4 të LPP-së. Sa i përket çështjes së borxhit që kërkon kreditori e që dallon nga borxhi i përmendur në dokumentin përmbartimore, përmbartuesi privat thekson se në rastin konkret debitori ka paguar pjesërisht borxhin dhe kërkesa e kreditorit ishte vetëm për pjesën e borxhit të pa përmbartur. Ndërsa lidhur me tarifën e efikasitetit, përmbartuesi privat thekson që organi përmbartues në këtë rast është mbështetur në dispozitat e nenit 5 të UA Administrativ për Tarifat e Përmbartuesit Privat përkatësisht nenin 27 par 2 të LPP, me të cilin specifikohet qartë se kur caktohet afati vullnetar për përmbarturje të detyrimit nga debitori dhe kjo ndodh vetëm “nëse në dokumentin përmbartues nuk është caktuar afati për përmbarturje vullnetare të detyrimit.” Në rastin konkret, dokumenti përmbartues (vendimi i dhënë në procedurë administrative) është përcaktuar qartë koha, afati dhe mënyra e kryerjes së obligimit. Rrjedhimisht, përmbartuesi privat kërkon refuzimin e propozimit.

Me datën 11.10.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, përfaqësuesi i divizionit, z. Petrit Reçica si dhe pala ankuese [REDAKTUAR] dhe përmbartuesit privat, [REDAKTUAR]

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbartimin Privat, znj, Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu edhe përfaqësuesi i divizionit ka ngelur pranë raportit të paraqitur me shkrim si dhe ka bërë elaborimin e tij përkatësisht edhe pala ankuese ka ngelur pranë ankesës. Përmbartuesi privat [REDAKTUAR] gjithashtu ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura ndaj tij.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se propozimi për fillimin e procedurës disiplinore është i pasafatshëm.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson që neni 375 i LPP-së, shprehimisht përcakton që “*procedura disiplinore (ndaj përmbartuesit privat theksimi i shtuar) mund të fillohet brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga dita e shkeljes së bërë, por jo më vonë se një (1) vit nga dita e shkeljes.*” Kjo do të thotë se procedura disiplinore ndaj përmbartuesve privat më së voni mund të fillohet brenda një (1) viti nga dita e shkeljes së pretenduar disiplinore. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës disiplinore shfaqet më vonë, afati fillon të rrjedh nga ajo kohë. Në rastin në fjalë, përmbartimi është lejuar me urdhrin P. nr 620/19 dt 28.03.2019 sipas propozimit për përmbartim të kreditorit [REDAKTUAR] mbi bazën e Vendimit nr. 12689 dt 28.12.2015, i cili vendim përcakton tarifën për një vit të studimeve, e cila për vitin 2015/2016 ishte përcaktuar 800 Euro, duke përfshirë shpenzimet procedural. Ndërsa pagesa nga pala debitore është bërë me dt 12.04.2019 në vlerën totale prej 502.02 euro. Sipas parashtruesit, Vendimi i këtij lloji nuk përfshihet në dokumentet e renditura nga neni 21, 22 dhe 29 të LPP-së dhe nuk gëzon besueshmërinë e përmbartimit apo nuk

ka titull ekzekutiv. Rrjedhimisht, shkelja e pretenduar i referohet urdhrin përmbartimor P. nr 620/19 dt 28.03.2019 dhe Vendimit nr. 12689 i cili lëshuar me dt 28.12.2015, dhe si të tilla, për këto pretendime për shkelje disiplinore nga ana e përmbartuesit privat [REDACTED] ka kaluar afati prej një (1) viti brenda të cilit mund të fillohej procedura disiplinore ndaj tij pranë Komisionit Disiplinor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 25/2021, datë 18.10.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.